


## I.1 PËRGATITJA E FORMATEVE TË PËRDORUESIT

Në shfletues mund të përcaktoni formate me të dhëna të ndryshme bibliografike dhe të dhëna të tjera, të cilat mund t'i përdorni në përgatitjen e bibliografive.

### Procedura

1. Në shfletues përzgjidhni metodën **Raportet / Formatet e përdoruesit për bibliografitë**.

Hapet dritarja **Redaktimi i formateve të përdoruesit** me listën e formateve që i keni përcaktuar. Në fillim lista është e zbrazët.



**Figura I.1-1: Dritarja Redaktimi i formateve të përdoruesit**

2. Shtoni formatin e ri të përdoruesit ose ndryshone formatin ekzistues (shih kap. I.1.1) ose fshini atë (shih kap. I.1.2).
3. Klikoni butonin **Mbyll**.



#### Këshillë:

Nëse dëshironi që formatin e përcaktuar ta përdorni tek bibliografitë, klikoni butonin **Bibliografitë**, me çrast hapet dritarja **Bibliografitë, emërtimet lëndore...** Më pas në dritaren **Parametrat e raportit** tek "Formati i njësive bibliografike" përzgjidhni formatin që e keni përcaktuar.



#### Shënim:

*Formatet e përcaktuara nuk janë të lidhura me emrin e përdoruesit, për këtë arsye ato mund t'i përdorin të gjithë kataloguesit e bibliotekës së veçantë.*

## I.1.1 Shtimi dhe ndryshimi i formateve të përdoruesit

Listën e formateve të përdoruesit, të cilën e keni përcaktuar, mund ta plotësoni me formatin e ri ose formatin ekzistues e ndryshoni.

### Procedura

Filloni nga dritarja **Redaktimi i formateve të përdoruesit**.

1. Për **shtimin** e formatit të ri klikoni butonin **Shto**.

Hapet dritarja **Shto formatin e përdoruesit**, në të cilën tek "Emri i formatit të përdoruesit" shënoni emrin e formatit.

2. Për **ndryshimin** e formatit të përcaktuar, të përzgjedhur në listë, klikoni butonin **Redakto**.

Hapet dritarja **Formatet e përdoruesit**.




Figura I.1-2: Dritarja Formatet e përdoruesit

3. Përcaktoni elementet për formatin e përdoruesit.

Nëse dëshironi që elementin ta **shtoni** midis elementeve të përzgjedhura, përzgjidhni atë në listën "Të gjitha elementet" dhe klikoni butonin **Shto**. Elementet që përmbajnë nënelemente kanë shenjën e shigjetës në të majtë.

Mund të shtoni elementet e pavarura (ikona **E**) ose nënelementet (ikona **E**), duke përzgjedhur secilin element veç e veç ose disa elemente njëherësh (përdorni tastin <Ctrl>).



Shënim:

*Nëse përzgjidhni disa nënelemente brenda së njëjtës zonë apo grup, në paraqitjen e bibliografisë të dhënat dyfishohen.*

Nëse dëshironi që elementin ta **largoni** nga lista "Elementet e përzgjedhura" përzgjidheni atë dhe klikoni butonin **Largo**.

4. Klikoni butonin **Ruaj**.


Në dritaren **Ruaj formatin e përdoruesit** konfirmoni edhe një herë emrin e formatit ose ndryshojeni atë, më pas klikoni butonin **Në rregull**.

5. Klikoni butonin **Mbyll**.



Këshillë:

Nëse dëshironi që formatin ekzistues ta ndryshoni dhe ta ruani me një emër të ri klikoni butonin **Ruaj si**.

Nëse dëshironi të verifikoni se nga cilat nënfusha të elementeve të veçanta të formatit mund të shfaqen të dhënat në bibliografi, klikoni ikonën . Lista është edhe në shtojcën I.2.

## I.1.2 Fshirja e formateve të përdoruesit

Formatet e përdoruesit i fshini në dritaren **Redaktimi i formateve të përdoruesit**.

### *Procedura*

1. Në listën "Formatet e përdoruesit" përzgjidhni formatin.
2. Klikoni butonin **Fshi**.  
Programi kërkon që fshirjen e formatit të konfirmoni.
3. Klikoni butonin **Në rregull**, më pas butonin **Mbyll**.